



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

Projekt

R R E G U L L O R E
P Ë R
EMËRTIMIN DHE RIEMËRTIMIN E SHKOLLAVE
NË KOMUNËN E GJILANIT

Gjilan, 2011

Në pajtim me nenin 12.2 pika c) dhe d) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr. 10/2008 dt 26.05.2008 - Emërtimi dhe riemërtimi i shkollave (institucioneve arsimore), Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me datën _____, miraton:

R R E G U L L O R E N

PËR EMËRTIMIN DHE RIEMËRTIMIN E SHKOLLAVE NË KOMUNËN E GJILANIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat për emërtimin dhe riemërtimin e institucioneve parashkollore, të shkollave fillore, shkollave të mesme të ulëta dhe shkolla të mesme të larta (në tekstin e mëtejme: shkolla).

Neni 2

1. Shkolla mund të emërtohet me:

- 1.1. emër personaliteti
- 1.2. emër gjeografik dhe
- 1.3. emër kuptimi.

2.1 Me emër personaliteti nënkuptojmë, një njeri shumë të rëndësishëm, të shquar në veprimtari shoqërore si në arsim, kulturë, art apo në veprimtari politike, ushtarake, shkencore, etj.

2.2. Me emër gjeografik nënkuptojmë fjalët që tregojnë shtetet, krahinat, malet, lumenjtë, detet, rrugët, sheshet, kontinentet etj.

2.3 Me emër kuptimi nënkuptojmë, një emër që në përmbajtjen e tij duhet të shpreh diçka nga realiteti.

Neni 3

Gjatë procedimit të emërimit dhe riemërimit të shkollës, të merren parasysh personalitetet e shquara nga komuna e Gjilanit, duke mos përjashtuar edhe personalitet nga viset tjera.

Procedura

Neni 4

1. Këshilli i shkollës i bën së paku tri propozime Drejtorisë Komunale të Arsimit.
2. Për secilin propozim shkolla duhet dhënë arsyetimin me shkrim.
3. Propozimet e dhëna nga pika 1 e këtij neni doemos duhet të përcillen me shkrim duke përshkruar figurën dhe veprimtarinë e tij.

Drejtoria Komunale e Arsimit

Neni 5

1. Propozimet që arrijnë nga Këshilli i Shkollës në Drejtorinë e arsimit para se të rekomandohen në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në pajtim me paragrafin 3 të kësaj rregulloreje dhe dispozitave të udhëzimit administrativ përkatës, duhet të kalojnë në Komisionin e emëruar nga Kuvendi i Komunës.
2. Komisionin e përbëjnë përfaqësuesit e subjekteve politike që janë pjesë e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

Neni 6

1. Drejtoria Komunale e Arsimit rekomandon njërin nga propozimet për emërtim apo riemërtim të shkollës .
2. Rekomandimi i DKA-së arsyetohet me shkrim.
3. Kërkesa e kompletuar për emërtim të shkollës me arsyetimin e dhënë i dërgohet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Ndërrimi i emrit

Neni 7

Procedura për riemërtimin e shkollës është e njëjtë me procedurën e emërimit.

Pengesat

Neni 8

1. Një shkollë nuk mund të emërtohet me:

- 1.1. emrin e personalitetit të gjallë dhe
- 1.2. dy shkolla të një komune nuk mund të kenë të njëjtin emër.

II. Dispozitat kalimtare

Neni 9

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregullore bëhet sipas procedurës së njëjtë të miratimit të kësaj rregulloreje.

Neni 10

Kjo Rregullore hyn në fuqi me miratimin nga ana e Kuvendit të Komunës dhe nënshkrimin e saj.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

01. Nr. _____

KRYESUESI I KUVENDIT

Izmi Zeka